



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 171, datë 25.05.2021

**PËR CAKTIM E Z. GENTI XHOLI, NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË APELIT TIRANË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë z. **Genti Xholi** në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Z. Genti Xholi të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë nga data 18.05.2021 - 17.05.2024.
3. Të ndërpresë caktimin e përkohshëm të Z. Genti Xholi, si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Genti Xholi, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Prokurori i Përgjithshëm.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.


KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**



**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

ANËTAR
KOSTAQ BELURI



ANËTAR
BUJAR SHESHI



ANËTAR
NURIHAN SEITI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR
MOISI DUDA



ANËTAR
VATË STAKA



ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ

